



Prishtinë: 05.08.2010

Kodi i ZRRE-së: V\_266\_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_398\_05\_10

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_398\_05\_10** ;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 21.07.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

**Në mbledhjen e mbajtur më 05 gusht 2010 nxori këtë:**

#### VENDIM

**REFUZOHET** apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Musa Cakaj (shifra e konsumatorit DPR – 10385) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

#### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 19.04.2010, ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 07.04.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 23.02.2006 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njëtori kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njëtorit elektrik nr 1064045, dhe kanë vendosur për matje të konsumit njëtorin elektrik me nr. 41547669.

**Provë:** Vërtetimi mbi ndërrimin e njëtorit elektrik i datës 23.02.2006

- Me datë 06.06.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për shkyçjen e konsumatorëve kanë bërë shkyçjen e konsumatorit me shifër DPR 10385, për shkak të borxhit në vlerë 396.75 €, ku kanë bërë rivulosjen e njehsorit me vulë distributive nr. A10065849 si dhe kanë konstatuar se një vulë shtetërore i mungon njehsorit.  
**Provë:** Procesverballi i KEK-ut nr. 329334 i datës 06.06.2009
- Me datë 11.08.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njësori kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njësorit elektrik nr. 41547669, dhe kanë vendosur për matje të konsumit njehsorin elektrik me nr. 17697620.  
**Provë:** Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 003024 i datës 11.08.2009
- Me datë 30.12.2009 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 415477669, ku është konstatuar se njehsorit elektrik një vulë (bllombë) shtetërore i mungon, një e ka të manipuluar të hapur dhe prapë të mbyllur, nga ana e jashtme njehsori dëmtime tjera nuk ka si dhe numëruesi i njehsorit është i manipuluar dhe ka gjurmë të gërvishtjes së numrave në numëror.  
**Provë:** Procesverballi me nr. 03/30 të datës 30.12.2009
- Me datë 22.08.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për shqyrtimin e saktësisë së njehsorit kanë shqyrtuar njehsorin me nr. 415477669 dhe kanë konstatuar se njehsori është brenda kufirit matës.  
**Provë:** Protokollin mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 2116 i datës 22.08.2009
- Me datë 11.02.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse. Punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë konstatuar se në pamundësi për t'i marrur pajisjet pasi që objekti është i pabanuar dhe kanë evidentuar se njehsori është i shkyçur dhe i vulosur (bllombuar).  
**Provë:** Procesverballi i KEK-ut nr. 146905 të datës 11.02.2010
- Me datë 18.02.2010 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR10HP08268 në vlerë prej 270.88 €.  
**Provë:** Fatura DPR10HP08268 e datës 18.02.2010
- Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 07.04.2010 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverballin e kontrollës dhe të kalibrimit.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 07.04.2010
- Me datë 17.04.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK\_V\_398\_05\_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** KEK-un për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimi të këtij Vendimi.

**Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar